



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010) dhe nenit 8, të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2016 miratoi:

Rregulloren për mbajtësin e mjeteve të pensioneve

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kushtet dhe udhëzimet për veprimtarinë e Mbajtësit të Mjeteve të Pensioneve.
2. Kjo Rregullore do të zbatohet për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, Fondet Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit, dhe Pensionet Plotësuese Individuale më tej (Fondi/et Pensional/e).

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe Ligjit nr.04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - a) **“Marrëveshja për mbajtjen e mjeteve pensionale”** - i referohet marrëveshjes, ndërmjet Fondit Pensional dhe mbajtësit lidhur me mbajtjen e mjeteve të pensioneve.
 - b) **“Mbajtja e mjeteve të pensioneve”** - përfshin mbajtjen e sigurt të mjeteve të pensioneve në pajtim me kushtet e marrëveshjes për mbajtjen e mjeteve pensionale.
 - c) **“Deklarata e parimeve të investimit”** - nënkupton politikën investuese dhe objektivat e zhvillimit të investimeve të përshtatura nga Fondi Pensional për investimin e mjeteve të pensioneve, e cila duhet të jetë në pajtim me Ligjin dhe rregulloret e BQK-së për pensione, ose me direktivat e investimit të cilat entiteti i pensionit ia përcakton menaxherëve të mjeteve ose mbajtësit.
 - d) **“Direktivat Investuese”** - nënkupton urdhrat dhe udhëzimet e bëra nga Fondi Pensional për menaxherin (et) e mjeteve ose mbajtësit, që specifikojnë termet, kushtet dhe mënyrën e investimit të mjeteve të pensioneve në pajtim me deklaratën e parimeve të investimit.

e) **OBZHE** – nënkupton Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

Neni 3

Mbajtje e mjeteve të pensioneve

1. Veprimtaria e mbajtjes së mjeteve të pensioneve do të ushtrohet nga mbajtësit e mjeteve të pensioneve të cilët janë të licencuar nga BQK-ja, apo nga një shtet anëtar të OBZHE-së sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin për fondet Pensionale të Kosovës dhe të kësaj rregulloreje.
2. Fondi Pensional duhet të emërojë një mbajtës të vetëm, të cilit ia delegon obligimin për mbajtjen e mjeteve pensionale dhe lidh marrëveshje për mbajtjen e tyre. Mbajtësi dhe punonjësit e tij, të cilët kanë liri veprimi sa u përket fondit pensional, sipas këtij ligji janë të besuarit e Fondit.
3. Fondi Pensional duhet të zgjedh mbajtësin me konkurs ndërkombëtar. Kushtet dhe procedura për udhëheqjen e konkursit, duke përfshirë edhe kërkesat paraprake të kualifikimit për mbajtësin, shumën dhe përbërjen e aksioneve të tij; arsyet dhe procedura e pezullimit ose anulimit të licensës së tij, do të përcaktohen në përputhje me Ligjin për Fondet Pensionale.
4. Mbajtësi mund të veprojë në këtë cilësi për më shumë se një fond, por mjetet pensionale, veprimet dhe evidencën e Fondit duhet t'i mbajë rreptësisht të ndara nga të gjitha mjetet e tjera dhe nga mjetet e mbajtësit.
5. Fondi Pensional do të njoftojë BQK-në për emërimin e mbajtësit të mjeteve të pensioneve.

Neni 4

Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së mbajtësit

1. Mbajtësi i mjeteve të pensioneve i cili është subjekt juridik në Kosovë duhet t'i plotësojë kushtet si vijon:
 - a) të jetë i licencuar nga BQK-ja, që nuk është nën masa të dhunshme dhe një licencë e tillë të mos jetë pezulluar;
 - b) të ketë kapital minimal të paguar siç përcaktohet me rregullore të BQK-së;
 - c) të mos veprojë si menaxhues i Fondit pensional dhe të mos jetë person i ndërlidhur i drejtorit të mjeteve ose anëtar i këshillit drejtues të Fondit;
 - d) të mos i jep para hua drejtorit ose anëtarëve të tij, por edhe të mos marrë para hua prej drejtorit të mjeteve ose anëtarëve të tij;
 - e) të jetë i licencuar nga BQK-ja në pajtim me rregulloret bankare dhe i autorizuar që të zhvillojë biznes bankar duke përfshirë edhe mbajtjen e mjeteve pensionale;
 - f) të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, Rregulloret e BQK-së për pensionet dhe ligjet tjera të aplikueshme;
 - g) të merr përsipër obligimet dhe përgjegjësitë fiduciare ndaj fondit pensional, pjesëmarrësve dhe përfituesve për bërjen e transaksioneve të matura të mjeteve

- pensionale nën kujdestarinë e tij. Ky obligim dhe kjo përgjegjësi fiduciare nënkuptohet të jetë e përfshirë në çdo marrëveshje, që ndërlidhet me mbajtjen e mjeteve pensionale;
- h) të mirëmbajë, administrojë, regjistrojë, llogaritë dhe të përgatitë raporte për mjetet pensionale të cilat i mban ndaras nga secila dhe të gjitha llogaritë tjera, të cilat mbajtësi i posedon në ushtrimin e veprimtarisë së përditshme; dhe
 - i) drejtorët, zyrtarët e lartë dhe punonjësit të cilët ushtrojnë ose mund të ushtrojnë ndonjë funksion në lidhje me mjetet e pensioneve do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes shtesë nga BQK-ja në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së mbajtësit të mjeteve të pensioneve.
2. Mbajtësi i mjeteve të pensioneve i cili është subjekt juridik jashtë Kosovës duhet të jetë i licencuar nga ndonjë rregullator i shërbimeve bankare, financiare ose i tregjeve të kapitalit të një shteti anëtar të OBZHE duhet të jetë në gjendje të qëndrueshme dhe mos të jetë nën masa detyruese, si dhe duhet t'i ofrojnë Fondit Pensional dhe BQK-së dëshmi të licencës, përmes së cilës dëshmohet se i është lejuar të merret me aktivitetin e mbajtjes së pensioneve.
3. BQK-ja mund të kërkojë informata apo dokumentacion shtesë lidhur me mbajtësin e mjeteve të pensioneve nëse ajo e konsideron të arsyeshme.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e mbajtësit të mjeteve të pensioneve

1. Mbajtësi i mjeteve të pensioneve duhet të:
- a) të pranojë dhe të mbajë letrat me vlerë që përbëjnë mjetet pensionale;
 - b) të mbajë evidencën e garancioneve të Fondit Pensional të çfarëdo forme;
 - c) të pranojë dhe t'i ruajë dokumentet e pagesave lidhur me transferin dhe emetimin e fondeve monetare që përbëjnë mjetet pensionale;
 - d) t'i regjistrojë llogaritë korresponduese në regjistrin e fondit pensional që janë deponuar te mbajtësi;
 - e) t'ia sigurojë Fondit tërë informacionin e nevojshëm për t'i ndihmuar në përmbushjen e obligimeve të këtij ligji;
 - f) të kujdeset që marrëveshjet për marrjen dhe tjetërsimin e fondit pensional të jenë në përputhje me këtë ligj apo me ligjet e tjera, me dispozitat në fuqi dhe me parimet investive të nxjerra nga Fondi;
 - g) t'i zbatojë udhëzimet e Fondit, me përjashtim të rasteve kur udhëzimet e tilla bien ndesh me këtë ligj dhe me dispozitat e tjera në fuqi ose me parimet investive;
 - h) të sigurojë që mjetet e fondit pensional të investohen në pajtim me këtë ligj e rregulloret e tjera në fuqi dhe me deklaratën e parimeve të investimit, kurse në rast të ndonjë shkeljeje të njoftohet Fondi sipas cilësdo procedure të njoftimit të saktësuar nga Fondi në marrëveshjen e tij me mbajtësin e mjeteve;
 - i) të sigurojë që drejtori(ët) i mjeteve t'i përmbushë detyrimet e veta lidhur me investimin e fondit pensional;

- j) t'i përmbush detyrimet e tjera të saktësuara në marrëveshjen e bërë me Fondin për mbajtjen e mjeteve dhe me rregullat e tjera që do të nxirren nga BQK-ja;
- k) sigurojë se menaxhuesi i mjeteve përmbush obligimet e tij ligjore në investimin e mjeteve të pensioneve;
- l) sigurojë se ka themeluar një sistem adekuat dhe efektiv të kontrollit të brendshëm lidhur me mbajtjen e mjeteve të pensioneve, për të kontrolluar çdo transaksion që përfshin përvetësimin dhe dispozicionin e mjeteve të pensioneve, kontabilitetin dhe informatat financiare në lidhje me to;
- m) raportojë me përpikëri Fondit Pensional, për çdo investim të mjeteve të pensionit, ku dyshohet se janë bërë shkelje të kornizës ligjore, që kanë të bëjnë me mjetet e pensioneve;
- n) përgatitë dhe raportojë, raportet e rregullta të kërkuara sipas kërkesave rregullative të BQK-së;
- o) raportojë Fondit Pensional, si dhe BQK-së çdo informatë, që mund të marrë lidhur me veprimet apo aktet që mund të rrezikojnë sigurinë e mjeteve të pensioneve të kryera qoftë nga personat fizikë apo juridikë;
- p) raportojë me përpikëri dhe drejtpërdrejt BQK-së ndonjë informacion, që ka të bëjë ose mund të ndodhë ndonjë mashtrim, pandershmëri ose keqpërdorim të mjeteve të pensionit e të shkaktuar nga fondi pensional, menaxhuesit e mjeteve të fondeve pensionale, ose nga personat përgjegjës të këtyre institucioneve; ose kur organet drejtuese të Fondit Pensional dështojnë, në adresimin ose ndërmarrjen e veprimeve përmirësuese për të shmangur shkeljet e detyrave ligjore ose fiduciare.

Neni 6

Marrëveshja për mbajtjen e mjeteve pensionale

Asnjë mbajtës nuk do të marrë në mbajtje mjetet e pensioneve, nëse nuk ekziston marrëveshje për mbajtjen e mjeteve të pensioneve me fondin e pensioneve.

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e marrëveshjes për mbajtjen e mjeteve pensionale

1. Çdo marrëveshje për mbajtjen e mjeteve pensionale duhet të jetë me shkrim, e cila duhet të përmbajë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e kërkuara nga mbajtësi i mjeteve të pensioneve sipas Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, kësaj rregulloreje dhe dispozitave të tjera të aplikueshme.
2. Përveç kërkesave sipas paragrafit 1 të këtij neni, marrëveshja për mbajtjen e mjeteve të pensioneve duhet të përmbajë së paku kërkesat si në vijim:
 - a) përgjegjësitë e saktësuara të mbajtësit;
 - b) mënyrën me të cilën ato duhet të realizohen;
 - c) shpërblimin e mbajtësit dhe mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve të pagesave si përqindje e fondit pensional që mbahet;
 - d) një dispozitë sipas të cilës mbajtësi i mjeteve pensionale merr për obligim apo garanton se të gjitha kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës dhe

rregulloreve në lidhje me mbajtjen e mjeteve të pensioneve do të zbatohen nga mbajtësi i mjeteve të pensioneve.

- e) një dispozitë sipas së cilës Fondi Pensional, bordi drejtues i tij, mjetet e pensioneve, pjesëmarrësit dhe përfituesit, do të jenë të mbrojtur, dhe do të dëmshpërblehen plotësisht nga mbajtësi për të gjitha shpenzimet e panevojshme apo të paarsyeshme, ngarkesat, humbjet ose dëmtimet, ose detyrimet e krijuara ndaj mjeteve të pensioneve për shkak të mashtrimit, pandershmërisë, akteve neglizhente ose shmangieve të mbajtësit, drejtorëve dhe zyrtarëve të tij.
- f) procedurat dhe kërkesat për përfundim të marrëveshjes, koha dhe mënyra me të cilën mjetet nën kujdestari do të transferohen tek mbajtësi i ri.

Neni 8

Kërkesat për mbajtjen e mjeteve pensionale përmes instrumentit për investime të hapura

1. Mbajta e mjeteve pensionale mund të bëhet përmes instrumentit për investime të hapura sipas kërkesave të nenit 11 të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës.
2. Mjetet pensionale të investuara përmes instrumentit për investime të hapura nuk u nënshtrohen kërkesave të neneve 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje.
3. Mbajtja e mjeteve pensionale përmes instrumentit për investime të hapura bëhet sipas marrëveshjes për mbajta të mjeteve pensionale.
4. Bordi Drejtues i Fondit Pensional, përmes raporteve/dokumenteve relevante të publikuara apo të papublikuara, si dhe raporteve të Auditorit të Jashtëm për tri vitet e fundit, duhet të sigurohet se mbajtësi i mjeteve pensionale përmes instrumentit për investime të hapura ka të themeluar sistem adekuat dhe efektiv të kontrollit të brendshëm për mbajtje dhe menaxhim të mjeteve të përbashkëta (“rezervat e mjeteve”) duke dokumentuar të gjitha blerjet, shitjet dhe transaksionet relevante në lidhje me investimet e mjeteve pensionale.

Neni 9

Ndërrimi i Mbajtësit të Mjeteve të Pensioneve

Fondi Pensional do të njoftojë me shkrim BQK-në 30 ditë para ndërrimit të mbajtësit të mjeteve.

Neni 10

Zbatimi dhe masat përmirësuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara me Ligjin për Fondet Pensionale.

Neni 11
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 8 mbi kujdestarin e mjeteve të pensioneve të datës 4 prill 2007.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 nëntor 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës
Prof. Dr. Bedri Peci.
